


NE ZGJEDHIM



SI TË JETUJMË

DEMOKRATËT E KOSOVËS

ETNA (11), RUVEJDA (11), BEHAR (11), LEART (11), FLANDRA (10), ARDIAN (12), ENES (12)



Në demokraci, jemi ne ata që vendosim për të ardhmen e shtetit tonë

Ne si qytetarë, jemi të vetëdijshëm se demokracia është një mënyrë e qeverisjes ku kemi të gjithë të drejta të barabarta pa marrë parasysh racën, gjuhën, gjininë, besimin, fesë etj.

Demokracia është shfaqur në vitin 507 p.e.s. Demokracia rrjedh nga fjalët greke „demos“ që do të thotë popull dhe „kratos“ që do të thotë qeverisje.

Disa nga elementet e demokracisë janë: liria, shprehja e mendimit, edukimi, respektimi, bashkëpunimi, solidariteti, paqja, toleranca, drejtësia, barazia, zgjedhjet, sovraniteti, përgjegjësia, etj.

Demokracia ndahet në demokracinë e drejtpërdrejtë dhe demokracinë përfaqësuese.

Demokracia e drejtpërdrejtë ka funksionuar në fillet e formimit të saj dhe vazhdon të funksionojë ende në disa shtete me numër të vogël të popullsisë. Në këtë formë të demokracisë, qytetarët marrin vendime në mënyrë të drejtpërdrejtë, përmes peticioneve apo edhe përmes referendumeve. Demokracia përfaqësuese është kur ne qytetarët i zgjedhim përfaqësuesit tonë me anë të votave të lira dhe pa imponime.

Demokracia përfaqësuese ndahet në dy sisteme: sistemi parlamentar dhe sistemi presidencial.

Në sistemi parlamentar ne qytetarët përmes daljes në zgjedhje, i votojmë deputetët të na përfaqësojnë den-

jesisht në Kuvend.

Ndërsa në sistemin presidencial qytetarët e votojnë Presidentin e një shteti dhe ai merr vendime për ta.

Në Kosovë funksionon sistemi i demokracisë parlamentare. Në demokraci, ne i kemi disa të drejta dhe disa përgjegjësi, për shembull: të drejtën për të jetuar të lumtur, të drejtën e shkollimit, të drejtën e të ushqyerit në mënyrë të shëndetshme, të drejtën e argëtimit, të drejtën për tu shoqëruar etj.

Ndërsa përgjegjësitë tona janë: t'i ndihmojmë njerëzit me nevoja të veçanta, t'i respektojmë të moshuarit, të mësojmë, t'i përfundojmë detyrat e shtëpisë, t'i respektojmë rregullat e komunikacionit, ta respektojmë ligjin, t'i dëgjojmë prindërit dhe mësuesit, të mos i ofendojmë dhe të mos i përqeshim të tjerët etj.




Ne jemi për një demokraci të mirëfilltë



Ato çka demokracia na ofron




Liria në demokraci




Funksionet e Kuvendit



Bashkëpunimi na bën më të suksesshëm



Elementet e demokracisë



Thuj jo diskriminimit

GAZETARËT E RINJË DEMOKRATIK

EDON (12), ENJËLL (11), YLLDRIT (12), ELLMA (12), FIRDEUSE (11), ERNES (11)

FUNKSIONET E KUVENDIT TË KOSOVËS



Ne mësuam se Kuvendi është pjesë shumë e rëndësishme e një shteti demokratik. Këto mësimë dëshirojmë t'i ndajmë me ju lexues të dashur

Ne jetojmë në Kosovë dhe shteti ynë është demokratik dhe i pavarur. Demokracia në vendin tonë dhe nëpër botë na siguron të drejtat e barabarta, liritë tona, barazinë etj.

Kuvendi ndryshe quhet shtëpia e popullit dhe luan rol shumë të rëndësishëm në realizimin e të drejtave tona. Kuvendi i Republikës së Kosovës ka detyrat dhe funksionet e veta. Detyrat e Kuvendit janë: përfaqëson shtetin dhe popullin, miraton, shfuqizon dhe propozon ligje, mbikëqyr punën e Qeverisë si dhe zgjedhë Qeverinë dhe Presidentin. Funksionet e Kuvendit të Republikës së Kosovës janë: funksioni përfaqësues sepse përfaqëson popullin, funksioni legjislativ sepse bën ligjet dhe funksionin kontrollues sepse kontrollon Qeverinë. Në Kuvendin e Republikës së Kosovës janë 120

deputetë. Në këtë Kuvend janë 39 gra dhe 81 burra. Po ashtu, në Kuvend ka deputetë të komuniteteve të ndryshme. 100 prej deputetëve janë qytetarë shumicë që janë shqiptarët nëfërs 20 prej tyre janë nga komunitetet jo shumicë që janë serbët, turqit, romët, boshnjakët, ashkalinjtë etj. Deputetët kanë aq shumë fuqi sa që mund ta shkarkojnë Presidentin. Ata po ashtu, kanë fuqi ta shkarkojnë edhe Kësryeministrin edhe ministrat të cilët punojnë në Qeveri. Deputetët kanë lloje të ndryshme të votimit, ato janë: me dorë, me shkrim ose me letër dhe në mënyrë elektronike. Deputetët kur votojnë me letër ose me shkrim, zgjedhin Presidentin e Republikës së Kosovës. Kryesia e Kuvendit të Kosovës përbëhet prej kryetarit dhe nën kryetarëve. Deputetët kanë mbledhje ditën e hënë dhe ata planifikojnë se çfarë do të diskutohet në seanca plenare që mbahen në ditën e enjte. Këto senanca mbahen për të mirën e popullit dhe deputetët aty flasin në emër të popullit. Faleminderit për leximin e artikullit tonë.



Gazetarët e rinjë duke punuar për artikull



Autorët e artikullit

DEMOKRACIA DHE ZGJEDHJET

ANES (11), ELZA (11), JON (11), ELTON (14), MINIRE (11), MERITON (11)

Në artikullin më poshtë do të mësoni për procesin zgjedhor në Republikën e Kosovës

Zgjedhjet janë një proces shumë i rëndësishëm i një vendi sepse me anë të tyre populli i zgjedh deputetët apo përfaqësuesit e shtetit. Të drejtë vote kemi nga moshë 18 vjeçare sepse atëherë jemi më të pjekur dhe e dimë më mirë se kë duhet ta votojmë. Kuvendi i Kosovës ka gjithsej 120 deputetë. Ata propozojnë dhe miratojnë ligje. Nga këto ligje të gjithë ne përfitojmë. Për shembull, një ligj i mirë për arsimin na ndihmon të gjithë neve nxënësve të cilët jemi pjesë e arsimit. Në Kosovë janë dy lloje të zgjedhjeve: qendrore dhe lokale. Në këto zgjedhje populli shpreh mendimin e vet lirshëm. Shprehja e mendimit të lirë, liria, paqja dhe respekti janë disa prej elementeve kyçe të demokracisë. Prandaj lexues të dashur votoni, sepse vota juaj ka vlerë të madhe.



Gazetarët e artikullit




Disa informata për zgjedhjet



Ndryshimi fillon nga ne



Ne e forcojmë demokracinë



Vota, sepse vota jote ka vlerë



IMPRESUM



Ky publikim është produkt i punës së pjesëmarrësve të projektit „Demos-ti“ i cili realizohet nga



REPUBLIKA E KOSOVËS / KUVENDI
REPUBLIKA KOSOVA / SKUPŠTINA
REPUBLIC OF KOSOVO / ASSEMBLY

i implementuar nga



Projekti është mundësuar dhe përkrahur nga



ERSTE Stiftung

Redaktohet nga
Kuvendi i Kosovës

Qëllimi i publikimit
Edukimi qytetar nëpërmes metodave edukative joformale

shtypur nga
TOKA

Na kontaktoni për të marrur pjesë: Pjesëmarrësit:
Tel: +381 38 704 560 SHFMU „Emin Duraku“
E-mail: info@demos-ti.org Klasa: VI-1
Website: www.demos-ti.org Vendi: Prishtinë